# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-442927**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Tabaku: Mungesa e transparencës dhe konkurrencës po dëmton rrugën e Shqipërisë drejt BE-së (VIDEO) |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/tabaku-mungesa-e-transparences-dhe-konkurrences-po-demton-rrugen-e-shqi-i586011` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 11:43:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 11:38:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `189dee82e1d6bc5927a6cdaab159be4248e49437400e0c43381b0eafdc57c113` |
| TEKSTI | `55941e1b0f3e1efbb24370e00eedf8dc84f37bf808bc711bc2cc74b1e145c46e` |
| PAMJA | `63d14faf486dfaaff094ceba150e8a8ba76ca03084ea14b237f6c568c66b767b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `56f72f39f80fe5756a18e7343018c856af67124f486031e920fed42054f44e1d` |
| E MËPARSHMJA | `525d86054ae4446c2a35aed310b599410ad65b8a9b93151da207d0e50a5e97e7` |
| RRËNJA MERKLE | `47dca60bb12c3dc439ebb43dab156a56f0c4323b738cbf9a7b5f92b8b605451e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/56f72f39f80fe5756a18e7343018c856af67124f486031e920fed42054f44e1d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Tabaku: Mungesa e transparencës dhe konkurrencës po dëmton rrugën e Shqipërisë drejt BE-së (VIDEO)

TemA
14 Shtator 2026, 13:38Politika TEMA



Deputetja demokrate paralajmëron se procedurat e ndjekura në tenderat publikë prekin drejtpërdrejt tre kapituj të negociatave, ndërsa cenojnë edhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, ka publikuar një tjetër video në rrjetet sociale, ku analizon pasojat që, sipas saj, ka afera KAYO në procesin e integrimit europian të Shqipërisë.

Tabaku argumenton se procedurat e ndjekura në sektorin e mbrojtjes dhe në tenderat publikë cenojnë parimet e transparencës, konkurrencës dhe shtetit ligjor, të cilat janë në themel të negociatave me Bashkimin Europian.

Sipas saj, çështja KAYO nuk është një rast i izoluar, por shfaqje e mënyrës së funksionimit të sistemit të ngritur nga mazhoranca socialiste, me procedura të centralizuara, mungesë transparence dhe favorizim të një grupi të kufizuar kompanish.

"Ky skandal prek themelet e shtetit dhe evidenton sistemin mbi të cilin ngrihet mazhoranca socialiste", deklaron Tabaku.

Deputetja demokrate thekson se pasojat e aferës prekin drejtpërdrejt tre kapituj të negociatave dhe, në mënyrë të tërthortë, edhe katër kapituj të tjerë. Sipas saj, cenohet gjithashtu Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, të cilën ajo e cilëson si "biblën e procesit të integrimit".

Tabaku rendit një sërë çështjesh që, sipas saj, kanë penguar përparimin e Shqipërisë gjatë viteve të fundit, duke përmendur ligjin për investimet strategjike, koncesionin e porteve, aferën e AKSHI-t dhe çështjen e mandatit të ish-zëvendëskryeministres.

Ajo e lidh mungesën e progresit me një model qeverisjeje që, sipas saj, ka prodhuar korrupsion, kosto më të larta për qytetarët dhe largimin e të rinjve nga

Ajo e lidh mungesën e progresit me një model qeverisjeje që, sipas saj, ka prodhuar korrupsion, kosto më të larta për qytetarët dhe largimin e të rinjve nga vendi.

“Ka vetëm një përgjigje: sistemi Rama. Pa e rrëzuar këtë sistem, nuk ka të ardhme europiane për Shqipërinë”, përfundon Tabaku.



## 2 Komente

**Toni**

14 Shtator 2026, 13:50

Eshte mire qe ne fillim duhet qe te beni trasparente pasurine qe ju keni bere me miliona € ju o virgjeresha Tabaku pastaj kerkon shume gjera. Kjo duhet te jete per te gjithe 140 te virgjerit e te virgjerat qe jeni ne ate Banken Vefa qe ju e quani Parlament .

Përgjigjjuni

👍 1 👎 0 ❤️ 0

---

**xhoxhi**

14 Shtator 2026, 13:53

Të dolli boja me këto analiza.Ty duhet të të besojmë apo B-E-në që thotë Shqipëria është në rrugën e duhur dhe ka bërë përparime.Edhe ne e dimë se ka shumë probleme por ju me këto që thoni nuk doni që Shqipëria të hyjë në B-E....dhe prisni ndonjë post kur të bëhet Berisha kryeministër...(do bëhet një mut me nder)

Përgjigjjuni

👍 0 👎 0 ❤️ 0

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Pagat e magjistratëve, Rama reagon sërish: Historia e botës s’e ka parë që gjykatësit të thonë do t’i marrim paratë vetë nga thesari i shtetit se janë tonat!]

13:29 Politika / 3 komente

[Kryetarët e bashkive të Rrjetit B40 deklaratë të përbashkët për mbajtjen në paraburgim të Veliajt: Po goditet demokracia vendore]

13:00 Politika / 3 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.